VENDIM
Nr.708, datë 25.8.2010

PËR BASHKËPUNIMIN E INSPEKTORATIT SHTETËROR TË PUNËS ME INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr.9634, datë 30.10.2006 "Për inspektimin e punës dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës", me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Inspektorati Shtetëror i Punës bashkëpunon me institucionet në varësi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit për:

a) shkëmbimin e informacionit për të dhënat e subjekteve që ushtrojnë veprimtari me leje të posaçme, të parashikuara në ligje të veçanta;

b) hartimin e programeve të punës për organizimin e kontrolleve të përbashkëta, sipas problematikës;

c) shkëmbimin e informacionit në rastet e konstatimit të shkeljeve të legjislacionit që nuk mbulohen nga institucioni që kryen kontrollin;

ç) bashkëpunimin në rast të hetimit të aksidenteve në punë, si dhe të sëmundjeve profesionale;

d) kryerjen e trajnimeve të përbashkëta për kualifikimin e specialistëve dhe të inspektorëve;

dh) kryerjen e studimeve për çështje të përbashkëta në fushën e sigurisë dhe të shëndetit në punë;

e) hartimin dhe zbatimin e projekteve që synojnë përmirësimin e sigurisë e të shëndetit në punë të punëmarrësve.

2. Inspektorati Shtetëror i Punës bashkëpunon me Inspektoratin Ndërtimor Urbanistik Kombëtar për sigurinë dhe shëndetin në punë, në fushën e ndërtimit.

3. Inspektorati Shtetëror i Punës bashkëpunon me Kapitanerinë e Përgjithshme të Porteve, për të pajisur me leje inspektorët e punës, me qëllim ushtrimin e kontrolleve për punëmarrësit që punojnë në porte, lidhur me zbatimin e legjislacionit të punës.

4. Për institucionet, që sipas ligjit, siguria dhe shëndeti në punë është detyrë e tyre, ISHP-ja do të kontrollojë zbatimin e dispozitave që lidhen me kushtet e punës, kohëzgjatjen e punës e të pushimit, pagat dhe punësimin e të miturve.

5. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha